



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRINLJENË DANA:		22.04.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
05-	453/01-	18462	



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

*Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Neni 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe neni 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, DKRS shpallë:*

## THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ

### MËRGATA FEST & SPORTS 2026

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

**Drejtoriati për Kulturë, Rini dhe Sport** bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, e që veprojnë në Komunën e Lipjanit ,programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektin **MËRGATA FEST & SPORTS 2026**

Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt përmes aktiviteteve si më poshtë:

#### Objektivat:

- Promovimi i kulturës,
- Promovimi i sportit,
- Promovimi i ngjarjeve kulturore të qendrueshme
- Promovimi i sportit ( Sportet e veqanta),
- Zhvillimi i aftësive sportive,
- Ndergjegjësimi në gara sportive dhe Fair – Play
- Nxitja e bashkëpunimit në ekipe
- Zgjerimi i aktiviteteve të të rinjve
- Nxitja e kreativitetit dhe inovacionit në Kulturë, Rini dhe Sport

#### Aktivitetet:

- Aktivitete kulturore 3 ditore: Përkujdesja (sigurimi) i emrave të këngëtarëve eminent të cilat përcaktohen në bashkëpunim me DKRS-në, por që duhet të prezentohen si propozime në projekt .
- Aktivitete tjera kreative, Inovative: Aktivitetet duhet të prezentohen si propozime në projekt
- Aktivitete sportive 3 ditore: Diciplina sportive me kategori, gjini dhe mosha të ndryshme, por që duhet të prezentohen si propozime në projekt .

**-Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë: OJQ –të të cilat me propozime janë më Inovative dhe Kreative.**

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **30,000.00 €**.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 501.00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 30,000.00 €.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me **13.05.2026**

OJQ-të mund të aplikojnë më së shumti me një (1) projektë në kuadër të kësaj thirrje,ndërsa perioda e zbatimit të projektit është 1 deri 30 ditë.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës,OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë,të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët,janë në dispozicion në faqen e internetit të *ofruesit të mbështetjes financiare* ( *web faqen* [www.komunaelipjanit-rks.org](http://www.komunaelipjanit-rks.org) ).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht,në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për Shërbim të Qytetarëve nr.1 dhe nr.2.

Procesi i pranimit,hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar Brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën ( [mergim.oruci@rks-gov.net](mailto:mergim.oruci@rks-gov.net) )

Lipjan, më :22.04.2026

Burim Rrustemi  
Drejtor i DKRS-së

